

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar referues, e Have Haliti, anëtare, me bashkëpunëtoresh profesionale Leonita Lajçi, si procesmbajtëse, në lëndën penale të akuzuarit T.M., nga Vitia, për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, av. Sh.Xh., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjiilan, PKR.nr.133/2017, të dt.27.09.2017, në seancën publike të kolegjit të mbajtur me dt.11.12.2017, morri këtë:

AKTGJYKIM

Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit T.M., av. Sh.Xh., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore- DKR në Gjiilan, PKR.nr.133/2017, të dt.27.09.2017, sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit, të akuzuarin T.M., për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KPRK, e më afër të përshkruar si në dispozitivin I të aktgjykimit, e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4(katër)muajve, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e në arrest shtëpiak prej dt.06.06.2017 e gjerë me dt.27.09.2017, ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 të KPRK-së, e më afër të përshkruar si në dispozitivin II të aktgjykimit dënimin e shqiptuar me gjobë në shumë prej 300 (treqindeuro) e merr si të vërtetuar, dhe i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë detyrohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse të njëjtin nuk e paguan në afatin e caktuar, dënimi i shqiptuar me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) €, do t'i llogaritet një ditë burgim.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Gjiilan, PKR.133/2017, të dt.27.09.2017, i akuzuari T.M., është shpallur fajtor për veprat penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KPRK dhe mbajtja në pronësi, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 të KPRK, për të cilat është gjykuar për veprën penale sipas dispozitivit nën I të këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, të cilin dënim i njëjti do ta mbajë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa për veprën penale në dispozitivin II të aktgjykimit me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, të cilin dënim me gjobë do ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu duke ia llogaritur nga 20 € për një ditë burg.

Në dënimin e shqiptuar me burgim të njëjtit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga dt.05.06.2017 deri me dt.27.09.2017.

Të akuzuarit T.M., i është shqiptuar dënimi plotësues konfiskimi i mjetit-tërfurkut si dhe pushkës së gjuetisë "Beretta", prodhim italian të kal.12GA.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 30 €, si shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë:

Mbrojtësi i të akuzuarit T.M., av. Sh.Xh., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KPRK-së, t'i shqiptojë dënim më të butë me kusht ose me gjobë, ose dënimin me burg në bazë të nenit 47 të KPRK-së, të zëvendësojë me dënim me gjobë.

Prokuroria e Apelit, me shkresën e saj PPA/I.nr.480/2017, të dt.16.11.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit T.M., av. Sh.Xh., ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, caktoi seancën e kolegjit, konformë nenit 390 par.1 të KPP, në të cilën morën pjesë i akuzuari T.M., ndërsa kanë munguar mbrojtësi i tij av. Sh.Xh. dhe Prokurori i Apelit-DKR në Prishtinë, i cili me shkresën e tij është deklaruar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit T.M., të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit T.M., av. Sh.Xh., edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, e duke marrë parasysh edhe sqarimin e Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit T.M., av. Sh.Xh., është e bazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit T.M., në ankesën e tij pretendon se shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa praninë e të dëmtuarit e cila dëshmi ka qenë e rëndësishme për vërtetimin se me cilin mjet i është shkaktuar lëndimi të dëmtuarit S.M.. Ndërsa, sa i përket sanksionit penal ankesa pretendon se dënimi është i lartë nuk është adekuat me veprimet e të akuzuarit që kanë ekzistuar rrethanat lehtësuese të cilat shkojnë në favor të akuzuarit se është njeri familjar, baba i 9 fëmijëve, ka sjellje të mira në gjykatë, si dhe është i gjendjes së rëndë ekonomike, edhe pse i akuzuari pjesërisht ka pranuar veprën penale të lëndimit të lehtë trupor dhe për këtë arsye ekzistojnë rrethana me të cilat mund të zbutet vendimi mbi dënimin.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, e sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1, vlerëson se aktgjykimi nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë. Gjykata ka dhënë arsye të të qarta dhe të plota rreth argumentimit të kryerjes së veprës penale nga ana e të akuzuarit, se i njëjti e ka kryer veprën penale me mjet të rrezikshëm me një tërfurk, që mund të shkaktohet lëndim i rëndë trupor ose dëmtim i rëndë i shëndetit, e kjo mbështetet edhe nga mendimi i ekspertit mjeko-ligjor, se lëndimi të e cila iu është shkaktuar të dëmtuarit i njëjti është shkaktuar me mjet të fortë mprehtës dhe si pasojë e kësaj janë shkaktuar dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, pretendimi ankimor i mbrojtësit të akuzuarit se deklarata e dëshmitarit - të dëmtuarit S.M., është lexuar në kundërshtim me dispozitat ligjore është i pabazuar për arsye se nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor del se deklarata është lexuar me pajtimin e palëve, e në bazë të dispozitës së nenit 338 par. 1.3 të KPP, dhe nga kjo del se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par 1 nën par 1.12 të KPP.

Gjykata e Apelit, edhe pse aktgjykimi nuk ankimohet për shkak të shkeljes së ligjit penal, të njëjtin e ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare edhe sipas kësaj baze ankimore si është paraparë në nenin 385 par. 1 të KPP-së, dhe gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vërtetuar se më dt. 04.06.2017, në rrugën "Hebib Sejdiu" i akuzuari T.M. ka pasur mosmarrëveshje për çështje pronësore me vëllain e tij S.M. dhe të njëjtit pas mosmarrëveshjes me një mjet të fortë-tërfurk, si mjet i rrezikshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, e godet të dëmtuarin në krahun e majtë dhe në kokë dhe pas veshit të majtë dhe i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin. Po ashtu, gjykata drejtë ka vërtetuar se më dt. 05.06.2017, te i akuzuari është gjetur se ka mbajtur në posedim pushkën e gjuetisë të llojit pumparicë njëtytëshe të markës "Bereta" të kalibrit 12 GA me nr. serik 911506 të cilën e ka mbajtur pa leje valide, nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar ligjin penal.

Gjykata e Apelit, duke i vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit lidhur me vendimin mbi dënimin, gjen se pretendimet e paraqitura ankimore janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vlerësuar rrethanat lehtësuese se i akuzuari ka shprehur keqardhje se është baba i 9 fëmijëve dhe ka pasur sjellje të mira në gjykatë, e të cilat rrethana gjykata i ka marrë si të vërtetuara. Gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethana tjera lehtësuese se i akuzuari me të dëmtuarin janë vëllezër dhe shqiptimi i dënimit me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve edhe më tepër mund t'i acarojë dhe ashtu raportet e tyre të këqija për shkak të mosmarrëveshjes rreth pronësisë dhe duke i marrë parasysh këtë fakt Gjykata e Apelit, dënimin e shqiptuar me gjobë në shumë prej 300(treqind)€, e merr si të vërtetuar, ndërsa, dënimin me burgim e ndryshoi dhe të akuzuarit ia shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër)muajve, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e në arrest shtëpiak prej dt.06.06.2017 e gjerë me dt.27.09.2017, dhe ky dënim i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, Gjykata e Apelit, duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana e ndryshoi aktgjykimin lidhur me vendimin mbi dënimin, me bindje se dënimi i shqiptuar të akuzuarit, në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPRK, si dhe preventivë individuale që të parandalojë të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe preventivës e përgjithshme që ti parandalojë edhe personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ndryshuar u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në konformë të nenit 403 par.1 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.511/2017, me dt.11.12.2017

Procesmbajtëse,

Leonita Lajçi

Anëtarët e kolegjit,

Fillim Skoro

Have Haliti

Kryetari i kolegjit,

Xhevdet Abazi